REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

**AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME**

**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

**SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT**

**Nr 305 prot** **Belsh me: 12 . 03 .2026**

**PROJEKT-VENDIM**

**" Për miratimin e vlerës financiare,të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e z.Hyqmet Çarciu , banor i fshatit Dëshiran, Njësia Administrative Grekan si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga fondi I kushtëzuar i Mbrojtjes Civile".**

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", ligjit 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", VKM nr.329 date 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", sektori i emergjencave ka bërë verifikimin në terren në objektin e **z.Hyqmet Çarçiu** ku ka konstatuar dëmtimin e objektit si dhe djegien e të gjitha orendive shtëpiake.Në këtë ngjarje tragjike si pasojë e zjarrit pronari humbi jetën në spitalin e QSUT.

Bashkia Belsh për ti ardhur sadopak në ndihmë familjes së të ndjerit z. Hyqmet Çarçiu i propozon Këshillit Bashkiak si më poshtë:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Belsh.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e **z. Hyqmet Çarçiu,** bazuar në V.K.M. nr. 329 datë 16.05.2012 e cila është sa shuma e 50% e vlerës së preventivit nga ana ndërtimore të përllogaritur me 100% e preventivit të orendive shtëpiake bazuar në dëmet e shkaktuara.Dmth **(630914.54 x 50%)+233475.6lekë= 548932.87 lekë** pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z.Hyqmet Çarçiu** është **548932.87 lekë** .
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare në shumën prej **548932.87 lekë**, për familjen e **Z.Hyqmet Çarçiu.**
4. Efekti financiar I pikës 3 do të perballohet nga Fondi I kushtëzuar I Mbrojtjes Civile me kodin e produktit 9107 AB.

**Konceptoi bazen ligjore:**

Griselda Toska

**Specialiste e EC dhe Strehimit :**

Emine Leka

**Drejtori i Agjensise :**

Arsen HYSA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BELSH AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
**AGJENCIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**
**SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT**

**Nr**306**prot** **Belsh me:** 12 . 03 **.2026**

# RELACION SHPJEGUES

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 " *Për Vetëqeverisjen Vendore*", ligjit 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", VKM nr.329 date 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*".
Në datën 28/08/2025 rreth orës 07 :10 në fshatin Dëshiran Njësia Administrative Grekan ka rënë zjarr në banesën e shtetasit Z.Hyqmet Çarçiu i datëlindjes 02/03/1940 banues në fshatin Dëshiran Bashkia Belsh .Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i verifikimit të ngritur me nr382 date 09.09.2025 si dhe akt-konstatimit të shërbimi të zjarrfikës rezulton se banesa është djegur plotësisht si pasojë e zjarrit pronari ka humbur jetën .Për ti ardhur në ndihmë familjarëve propozojmë dëmshpërblimin për dëmet materiale në banesë për 50% e preventivit për anën ndërtimore dhe 100% e orendive shtëpiake. Vlerësimi dhe hartimi i preventivit të dëmeve është mbështetur në çmimet e referencës të dërguara nga Prefektura në përputhje me udhëzimet përkatëse.
**Bashkangjitur do të gjeni :**

- Shkresën me Nr.1367/1 prot.date 05.01.2026 nga Prefekti i Qarkut mbi dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e ndihmës financiare për dëmet në rast fatkeqësie natyrore.
- Kërkesën e familjarit të dëmtuar
- Çertifikatën familjare në momentin kur i ka ndodhur fatkeqësia
- Urdhëri i Kryetarit Të Bashkisë për ngritjen e Komisionit të konstatimit të dëmeve dhe gjëndjes së fatkeqësisë .
- Procesverbali i konstatimit të gjëndjes dhe verifikimit të dëmeve.
- Preventiv i dëmeve nga ana ndërtimore në masën 50% të vlerës.
- Preventivi në pajisje dhe orendi shtëpiake në masën 100% të vlerës së çmimit sipas shkresës me nr 488/2 date 05.05.2025 mbi çmimet e referencës.
- Vërtetim/Raport nga MZSH .

**Konceptoi bazën ligjore:**
Griselda Toska
**Specialiste e EC dhe Strehimit :**
Emine Leka

**Drejtori i Agjencise :**
Arsen HYSA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE**

**ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE**

**Nr.**743**Prot .** **Belsh më** 12.03**.2026**

**PROJEKT-VENDIM**

**Për propozim për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 01.02.2026- 28.02.2026**

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr 9355,datë 10.03.2005, i ndryshuar me Nr 57/2019 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore",i ndryshuar i cili parashikon që "Këshilli i Bashkisë Belsh ka të drejtë të miratojë kritere specifike për dhënien e ndihmës ekonomike me fondet e buxhetit vendor,dhe deri në 6% të fondit te kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për familjet me më shumë pjestarë ose familjet në nevoje ".Zyra e ndihmës ekonomike bazuar dhe në verifikimet e bëra nga ana jonë **propozojmë dhe konkludojmë** të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin **SHKURT 2026 për Bashkinë** ,me një fond për_____ **familje** , një fond prej______________ **lekë.**

**Fondi i Bashkisë për familjet në nevojë .**

Lista e familjeve të cilat ne propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike janë familje ekstremisht të varfëra dhe nuk janë përzgjedhur për të përfituar nga sistemi pilot i NE për shkak të sistemit të ri të pikëzimit.

**PËRGJEGJËSE NE**
**Entela DERVISHI**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

*Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,* bashkiabelsh@hotmail.com

**Bashkia BELSH**

Lista e bordoros SHKURT 2026 Projekt-Vendimit në total të familjeve të propozuara për të përfituar me 6% e fondit të bllok-ndihmës për periudhën **1-28.02.2026**

| Nr | Njësia Administrative | Numri familjeve | Fondi |
|---|---|---|---|
| 1 | Belsh | 15 | 66098 |
| 2 | Grekan | 9 | 23738 |
| 3 | Kajan | 4 | 20592 |
| 4 | Rrasë | 1 | 3703 |
| 5 | Fierzë | 0 | 0 |
| | **Totali** | **29** | **114131** |

**PËRGJEGJËSE NE**
**Entela DERVISHI**

**KRYETARI BASHKISË**
**Arif TAFANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

*Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,* bashkiabelsh@hotmail.com

LISTË PAGESA E PERSONAVE QË PAGUHEN NË SKEMËN E 6 % PËR MUAJIN SHKURT 2026

| Nr | Emri i Aplikantit | Admin parave | NID Admin parave | Nr.an | Vlera e përllogaritur për fondin 6% | K.E | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sajde Ymer Paja | Sajde Ymer Paja | H05201011U | 1 | 2178.00 | | 2178.00 |
| 2 | Elona Xhevit Zekthi | Elona Xhevit Zekthi | I75416023R | 3 | 3267.00 | | 3267.00 |
| 3 | Muin Shyqyri Pepa | Sanije Murat Pepa | G65822007F | 2 | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 |
| 4 | Shqipe Ali Abazi | Shqipe Ali Abazi | H35710011O | 1 | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 5 | Kujtim Ramazan Ahmeti | Hamide Xhevit Ahmeti | G76208004L | 2 | 3703.00 | | 3703.00 |
| 6 | Anxhela Avni Dervishi | Anxhela Avni Dervishi | J75622011I | 2 | 5940.00 | | 5940.00 |
| 7 | Manjola Bajram Hysa | Manjola Bajram Hysa | I95603009R | 4 | 8712.00 | | 8712.00 |
| 8 | Edlira Ferit Muça | Edlira Ferit Muça | H85202013D | 1 | 1525.00 | | 1525.00 |
| 9 | Marsida Shefqet Zekthi | Marsida Shefqet Zekthi | J06124010N | 2 | 1980.00 | | 1980.00 |
| 10 | Manushaqe Veiz Uruçi | Manushaqe Veiz Uruçi | I25511012V | 3 | 8712.00 | | 8712.00 |
| 11 | Besim Ramadan Dyrmyshi | Zamira Demir Dyrmyshi | I45416019J | 3 | 4792.00 | | 4792.00 |
| 12 | Albana Aqif Hysa | Albana Aqif Hysa | H96031005Q | 2 | 5940.00 | | 5940.00 |
| 13 | Fatmir Livan Kasa | Fiqnete Bexhet Kasa | G55820014A | 2 | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 14 | Ruzhdi Shyqyri Bali | Marjeta Bajram Bali | H05203007C | 2 | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 15 | Floresha Sadri Ferhati | Floresha Sadri Ferhati | H26220005G | 2 | 3960.00 | | 3960.00 |
| 16 | Kristina Bajram Skënderi | Kristina Bajram Skënderi | J95627010E | 2 | 5940.00 | | 5940.00 |
| 17 | Anxhela Shefqet Senia | Anxhela Shefqet Senia | J66104014U | 2 | 5940.00 | | 5940.00 |
| 18 | Taulant Qani Lleshi | Taulant Qani Lleshi | I50412016C | 1 | 2178.00 | | 2178.00 |
| 19 | Myzejen Hazis Senia | Myzejen Hazis Senia | G55629011P | 1 | 3146.00 | | 3146.00 |
| 20 | Ervina Shpëtim Koçiu | Ervina Shpëtim Koçiu | J35425019I | 1 | 0.00 | | 0.00 |
| 21 | Andra Shpëtim Koçiu | Andra Shpëtim Koçiu | J15506025E | 1 | 0.00 | | 0.00 |
| 22 | Dashurie Petrit Sinani | Dashurie Petrit Sinani | G65827050J | 1 | 2178.00 | | 2178.00 |
| 23 | Fatmir Aqif Madhi | Fatmir Aqif Madhi | G41229010J | 1 | 2178.00 | | 2178.00 |
| 24 | Tajar Hysen Bezati | Kadrije Shefqet Bezati | G16204004I | 2 | 2178.00 | | 2178.00 |
| 25 | Florenc Ali Elezi | Zamira Rushan Elezi | I26103008M | 4 | 6752.00 | | 6752.00 |
| 26 | Sonila Yzeir Koçiu | Sonila Yzeir Koçiu | J85221010H | 2 | 5940.00 | | 5940.00 |
| 27 | Saide Qamil Karaj | Saide Qamil Karaj | G05605019A | 1 | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 |

*Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,* bashkiabelsh@hotmail.com

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | Fatime Xhaferr Xhafa | Fatime Xhaferr Xhafa | G65526008B | 1 | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 29 | Arta Xhevit Meta | Arta Xhevit Meta | H95405017L | 2 | 3703.00 | | 3703.00 |
| | | | | 54 | 106403.00 | 7728.00 | 114131.00 |

**PËRGJEGJËSE NE**
**Entela DERVISHI**

**KRYETAR I BASHKISË**
**Arif TAFANI**

*Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,* *bashkiabelsh@hotmail.com*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE**

**ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE**

**Nr.762 Prot .** **Belsh më 12.03.2026**

RELACION DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK .

Në mbështetje të nenit 100 te Kushtetutes te neneve 12,pikat 1,4,5 te ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 Për ndihmën dhe shërbimet shoqerore ,të ndryshuar te Vendimit nr.57 datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike Kreu IV "Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" ku thuhet se :Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit ,duke përdorur deri ne 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmë ekonomike.

Kërkojmë që Këshilli Bashkiak të miratojë këtë Projekt -vendim të sjellë nga zyra jonë.

**Faleminderit për bashkëpunimin!**

**PËRGJEGJËSE NE:**

**Entela DERVISHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
**AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**
**SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT**

**Nr** 302 **prot** **Belsh me:** 12 . 03 **.2026**

PROJEKT-VENDIM

**"Për miratimin e vlerës financiare të humbjes së jetës të Z.Hyqmet Çarçiu ,Fshati Dëshiran ,Bashkia Belsh dhe shpërblimin financiar sipas vkm 329 nga Fondi i kushtëzuar''**

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 '' *Për Vetëqeverisjen Vendore*", ligjit 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", VKM nr.329 date 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*",sektori i Emergjencave në bashkëpunim me sektorin e MZSH ka bërë konstatimin e dëmeve materiale si dhe gjendjen shëndetësore të z. **Hyqmet Çarçiu** i cili ndërroi jetë si pasojë e plagëve të marra nga zjarri.

Bashkia Belsh për të ardhur në ndihmë familjes së të ndjerit z.Hyqmet Çarçiu i propozon Këshillit Bashkiak si më poshtë :

1.Të miratoj dhënien e ndihmës financiare sipas VKM.329,në shumën prej 500.000 (pesëqind mijë ) lekë ,për familjen e të ndjerit.

Efekti financiar në pikën e parë do të përballohet nga Fondi i Kushtëzuar I Mbrojtjes Civile.

Bashkëngjitur do të gjeni të gjithë dosjen me dokumentacionin përkates.

**Ju faleminderit!**

**Konceptoi bazen ligjore:**
Griselda Toska
**Specialiste e EC dhe Strehimit :**
Emine Leka

**Drejtori i Agjensise :**
Arsen HYSA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME
BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
**AGJENCIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**
**SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT**

**Nr 303 prot** **Belsh me: 12.03.2026**

RELACION SHPJEGUES

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 " *Për Vetëqeverisjen Vendore*", ligjit 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", VKM nr.329 date 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*".

Në datën 28/08/2025 rreth orës 07 :10 në fshatin Dëshiran Njësia Administrative Grekan ka rënë zjarr në banesën e shtetasit **Hyqmet Çarçiu** i datëlindjes 02/03/1940 banues në fshatin Dëshiran Bashkia Belsh .Sipas të dhënave të administruara nga strukturat vendore dhe njoftimit të shërbimit të zjarrëfikses zjarri ka përfshirë të gjithë banesën duke shkaktuar dëme materiale dhe dëmtime serioze shëndetësore për pronarin e banesës.Pas ndërhyrjes së shërbimit zjarrëfikës shtetasi u transportua menjëherë në spitalin e Elbasanit dhe më pas në QSUT Tiranë , por si pasojë e plagëve dhe dëmtimeve të marra nga flakët fatëkeqësisht ndërroi jetë në datën 29/08/2025 në ambjentet e spitalit .

Ky informacion bazohet në njoftimet e marra nga organet përgjegjëse dhe skeda e vdekjes e marrë nga spitali .
Bashkangjitur do të gjeni :

- Shkresë nr.1368/1 date 05.01.2026 nga Prefekti i Qarkut për përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Mbrojtjes Civile në rast humbje jete si rezultat i fatkeqësive natyrore.
- Kërkesën e familjarit të dëmtuar
- Çertifikatën familjare në momentin kur i ka ndodhur fatkeqësia.
- Urdhëri i Kryetarit Të Bashkisë për ngritjen e Komisionit të konstatimit të dëmeve dhe gjëndjes së fatkeqësisë .
- Vërtetim/Raport nga MZSH .
- Skeda e vdekjes .
- Akti i trashëgimisë.

**Konceptoi bazën ligjore:**
Griselda Toska
**Specialiste e EC dhe Strehimit :**
Emine Leka

**Drejtori i Agjencisë**
Arsen HYSA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME
BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**
**DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE**

Nr. 778 prot    Dt. 13/03/2026

**PROJEKT -VENDIM**

Nr._____DATE / / 2026

**"Miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Programit të Punës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029"**

Mbeshtetur në ligjin nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore", ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Per Menaxhimin e sistemit Buxhetor ne republiken e Shqiperise", ligjin **nr.68/2017** dt.27/04/2017 **"Për Financat Vendore"** dhe udhëzimit te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **nr.7** datë 27.02.2026 **"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029".** Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

1. Te miratoje Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe Programin e Punës për projekt buxhetin 2027-2029, bashkangjitur projekt-vendimit Programi i Punës " Për përgatitjen e Projekt – Buxhetit 2027-2029".

| Juristi | Drejtoria e Finances | Kryetari i Bashkise |
|---|---|---|
| Desara MUSTA | Alban NIPOLLI | Arif TAFANI |

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

# RELACION

## PROGRAM PUNE

Nr.779.Prot Belsh më:13.03.2026

Për Përgatitjen e Projekt Buxhetit 2027-2029

Mbeshtetur në ligjin nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore", ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Per Menaxhimin e sistemit Buxhetor ne republiken e Shqiperise", ligjin **nr.68/2017** dt.27/04/2017 **"Për Financat Vendore"** dhe udhëzimit te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **nr.7** datë 27.02.2026 **"Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029".** ngrihet Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si me poshtë:

1. Arif Tafani-Kryetari i GMS
2. Romina Mema-Nënkryetari i NJQV
3. Maringlen Bali-Koordinator i GMS
4. Alban Nipolli-Sekretar i GMS
5. Ornela Uruçi- Zyrtari Përgjegjës për Buxhetin
6. Ana Musta- Koordinator Risku
7. Ditjon Pepa-Zyrtari përgjegjës për të Ardhurat
8. Agron Sina- Drejtues i Programit Administrim, Menaxhim, Planifikim
9. Sheje Ndoni- Sekretar i Programit Administrim, Menaxhim, Planifikim
10. Ndriçim Reka- Drejtues i Programit Menaxhimi për Zhvillim Ekonomik dhe Mirmbajtja e Rrugëve
11. Esma Zika- Sekretar i Programit Menaxhimi për Zhvillim Ekonomik dhe Mirmbajtja
12. Ramadan Çekrezi- Drejtues i Programit Shërbime publike dhe Mbrojtja e Mjedisit
13. Julgin Rika - Sekretar i Programit Shërbime publike dhe Mbrojtja e Mjedisit
14. Alketa Hysa -Drejtues i Programit Arsimi, Kultura dhe sporti
15. Orjeta Hysa- Sekretar i Programit Arsimi, Kultura dhe sporti
16. Enian Ferhati - Drejtues i Programit Fondi Rezerve dhe Kontigjenca
17. Matea Gjoshi-Sekretar i Programit Fondi Rezerve dhe Kontigjenca

Grupi për menaxhimin Strategjik (GMS), sipas udhëzimit nr.7 date 27.02.2026 te Ministrisë së Financave, duhet të zbatojë me korrektesi te gjitha kriteret dhe kerkesat qe jane percaktuar ne kete udhezim dhe afatet sipas programit te punës.

për hartimin e Projekt-Buxhetit 2027– 2029 duhet të mbështetet në këto drejtime kryesore:

1. Te zbatoje me korrektësi te gjitha kriteret dhe kërkesat qe janë përcaktuar ne udhëzimin e Ministrisë së Financave
2. Këshilli i njësisë se Vetëqeverisjes Vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe te parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo me vonë se data 1 Mars 2026.
3. Brënda datës 15 Mars 2026 miratohen në Këshillin Bashkiak Tavanet Përgatitore të shpenzimeve buxhetore afatmesme.
4. Brënda muajit Prill të përgatiten kërkesat Buxhetore.
5. Kërkesat Buxhetore te dorëzuara te koordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga grupi i GMS.
6. Brënda datës 1 Qershor 2026 Kryetari i Bashkisë duhet të dërgoje me shkrim dhe në rruge elektronike ne Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projekt dokumentin e PBA 2027-2029.
7. Brënda datës 20 Qershor 2026 Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon dhe përgatit një raport me rekomandime mbi Projekt dokumentin e PBA 2027-2029.
8. Kryetari i Bashkisë paraqet pranë Këshillit të NJVQV-së, Projekt dokumentin e PBA 2027-2029, të miratuar nga Grupi GMS së bashku me raportin me rekomandime të Ministrisë së Financave.
9. Brënda datës 30 Qershor Këshilli i NJVQV-së shqyrton dhe miraton projekt dokumentin e pare te PBA 2027-2029.
10. Brënda datës 5 Korrik, Kryetari i Bashkisë merr masa të nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të PBA 2027-2029.

**KRYETARI I BASHKISE**

**Arif TAFANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE, TË ARDHURAVE VENDORE DHE ZYRËS NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. 777. prot Dt.13/03/2026

**PROJEKT -VENDIM**

Nr._____DATE / / 2026

**"Miratimin e Tavaneve të të Ardhurave dhe Shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2027-2029"**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligjin **nr.68/2017** dt.27/04/2017 **"Për Financat Vendore"**, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **nr.7** datë 27.02.2026 **"Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029".**

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

1. Të miratojë **Tavanet e të Ardhurave dhe Shpenzimeve** për Projekt Buxhetin 2027-2029, sipas tabelës dhe relacionit bashkangjitur.

| Juristi | Drejtoria e Finances | Kryetari i Bashkise |
|---|---|---|
| Desara MUSTA | Alban NIPOLLI | Arif TAFANI |

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr._____.Prot Belsh më:____.____.2026

**RELACION**

**"Mbi hartimin e dokumentit të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029".**

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 7 datë 27/02/2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029". Bashkia Belsh mori te gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit 2027-2029 duke u bazuar në të gjitha kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i mësipërm. Për hartimin e Projekt - Buxhetit 2027-2029 duhet të ngrihet sipas Udhëzimit Nr.7 date 27.02.2026 grupi për menaxhimin strategjik (GMS) i cili duhet te zbatoje me korrektësi te gjitha kriteret dhe kërkesat qe janë përcaktuar ne ketë udhëzim, dhe afatet sipas programit të punës. Duke u bazuar në udhëzimet e ardhura për këtë qëllim Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të përcaktojë prioritetet kryesore për periudhën 2027-2029.

Gjatë hartimit të Projekt Buxhetit si për burimet financiare dhe shpërndarjen e tyre janë mbajtur parasysh të gjitha prioritetet më te domosdoshme për periudhen 2027-2029, duke evidentuar dhe planifikuar të gjitha burimet e mundshme financiare të vetë Bashkisë dhe burimet financiare të ardhura nga transferta e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar si fondet e tjera te ardhura nga fondi i zhvillimit rajonal, Akum etj. Gjatë hartimit te Projekt buxhetit janë bërë takime me grupet e interesit dhe komunitetin dhe të gjitha kërkësat dhe prioritete e dala ju paraqiten Nënpunësit e Autorizuar. Në hartimin e burimeve financiare te Bashkise Belsh janë mbajtur parasysh të gjitha udhëzimet dhe ligjet për taksat vendore dhe mbi ketë baze janë parashikuar te ardhurat dhe shpenzimet. Ndërsa për transferten e pakushtëzuar për cdo vit 2027-2029 është mbajtur parasysh kriteri i përcaktuar ne udhëzimin nr.7 date 27.02.2026.

Me poshtë po trajtojmë disa nga treguesit më kryesor të tavaneve:

Për sa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2027-2029 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioritete më të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos në investime.

Struktura e programeve te buxhetit vendor Belsh do te jete si me poshtë:

| Nr | Programi | Kodi i programit |
|---|---|---|
| 1 | PLANIFIKIMI, MANAXHIMI DHE ADMINISTRIM | AA152 |
| 2 | RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE | AB152 |
| 3 | MBESHTETJE PER ZHVILLIM EKONOMIK DHE MIRMBAJTJA E RRUGEVE | AC152 |
| 4 | SHERBIMET PUBLIKE VENDORE DHE MBROJTJA E MJEDISIT | AD152 |
| 5 | ARSIMI KULTURA DHE SPORTI | AE152 |
| 6 | FONDI REZERVE DHE KONTIGJENCA | AF152 |

Persa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2027-2029 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioriteteve me të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos ne investime.

Totali i shpenzimeve sipas viteve paraqitet si më poshtë:

000/mijë lekë

| Nr | EMERTIMI | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Tot.Shpenzimeve | 1,145,579 | 817,391 | 518,436 | 525,245 | 536,295 | 439,605 |

Sic shikohet nga të dhënat e mësipërme për vitin 2026 shpenzimet janë bërë mbi bazën e planifikimit të të ardhurave të veta të Bashkisë, nga transferta dhe të ardhura të trashëguara nga viti 2025 dhe nga transferta të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara që gjenerohen nga Qeveria per vitin aktual. Ndersa Planifikimi afatmesëm i të ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën 2027-2029 është bërë mbi bazën e udhezimit nr. 7 date 27.02.2026 per transferten e pakushtezuar sektoriale, parashikimin e te ardhurave afatmesme te bera nga sektori i taksave ne Bashkine Belsh dhe transferten e pakushtezuar qe sjell qeveria per planifikimin afatmesem .

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitet 2027-2029 paraqitën si më poshtë :

000/mijë lekë

| Nr | EMERTIMI | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Shp. Page | 186,630 | 219,936 | 233,655 | 235,629 | 235,967 | 271,011 |

Përqindja që zënë shpenzimet për pagat e ndaj totalit të shpenzimeve:

000/mijë lekë

| Nr | EMERTIMI | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | %Pagave+ sig.shoqerore | 23% | 33% | 36.9% | 42.2% | 51.3% | 66.1% |

Sic është përmendur edhe më lartë në hartimin e Projekt Buxhetin 2027-2029 prioriteti kryesor kanë qenë shpenzimet për investime si me burimet financiare nga vete Bashkia dhe financimet nga donatorë të tjerë. Në këtë Projekt Buxhet tre prioritete kryesore janë Investimet në Ujitje dhe Kullim, arsim dhe Investimet në infrastrukturë, rrugët rurale.

Për investimet është planifikuar një fond i konsiderushëm kështu për vitin 2027 janë planifikuar 9% te totalit te shpenzimeve, per vitin 2028 jane planifikuar 11 % te totalit te shpenzimeve dhe per vitin 2029 jane planifikuar 12% te totalit te shpenzimeve.

Këto ishin tavanet e planifikuar për të ardhurat dhe shpenzimet për PBA-së 2027-2029, me kërkesat dhe propozimet që do të bëhen nga anëtaret e këshillit do të përfshihen në PBA përfundimtare dhe brenda datës 1 Qershor do ti dërgohen Ministrisë së Financave do të bëhën përmirsimet e nevojshme dhe do te paraqiten në Këshillin Bashkiak për miratimin Përfundimtar të PBA-së 2027-2029.

| | | |
|---|---|---|
| **Specialiste Finance** | **Dr/Financës** | **Kryetari** |
| **Ornela URUÇI** | **Alban NIPOLLI** | **Arif TAFANI** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH